



**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren**  
**Fakulteti Juridik**

Adresa: Rr. Shkronjave 1, 20000  
Prizren Republika e Kosovës

**PLANI STRATEGJIK 2023/2026**



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
Fakulteti Juridik

**FAKULTETI JURIDIK – PËRGJITHSHËM**

**Plani Strategjik**

**2023-2026<sup>1</sup>**

**Aftësimi për të ardhmen**

---

<sup>1</sup> Vini re pas një viti do rishikohet krahas hartimit të Planit Strategjik të UPZ-se



## SHKURTESAT

<b>UUHP</b>	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
<b>FJP</b>	Fakulteti Juridik Përgjithshëm
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>SHU</b>	Shoqata e Universiteteve
<b>MM</b>	Memorandum Mirëkuptimi
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>ZBN</b>	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>ZIK</b>	Zyra për Zhvillim të Cilësisë
<b>QKA</b>	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
<b>BKI</b>	Bordi Këshillëdhënës Industrial
<b>KA</b>	Këshilltar Akademik
<b>TI</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>USAID</b>	Ndihma e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
<b>KSHC</b>	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
<b>PS</b>	Parlamenti Studentor
<b>NJA</b>	Njësitë Akadematike



# PËRMBAJTJA

## Fjala e dekanit

## Historiku i Fakulteti Juridik

### 1. Themelimi i planit strategjik

- Misioni
- Vizioni
- Vlerat
- Grupet e interesit

### 2. Procesi i planifikimit strategjik

- Analiza e zbatimit

### 3. Prioritetet strategjike

- Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësim nxënie
- Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
- Arsimitimi i vazhdueshëm gjate gjithë jetës
- Hapja e programeve te reja ne tre nivelet (Bsc, Msc, Dr)
- Kontributi në komunitet
- Aftësimi teorik dhe praktik për tregun e punës
- Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit
- Zhvillimi i infrastrukturës
- Qëndrueshmëria financiare

### 4. Plani i veprimit



## FJALA E DEKANIT

Të dashur Student, në cilësinë e Dekanit të Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (UPZ), kam kënaqësinë e veçantë, që në emër të stafit akademik, administrativ, bashkëpunëtorëve të jashtëm, studentëve si dhe në emrin tim personal, të ju dëshirojë suksese në aftësimin e juaj profesional dhe akademik.

Fakulteti Juridik, si institucion arsimor akademik i nivelit vendor dhe ndërkombëtar për të studiuar dhe aftësuar në fushën juridike në bazë të parimeve vendore dhe ndërkombëtare, ku studenti gjithmonë është në qendër të vëmendjes.

Fakulteti Juridik i Përgjithshëm i UPZ-se, institucion arsimor akademik organizon programin e studimit në nivelin "Bachelor". Angazhohet me një dinamik të shtuar, në hapjen e programeve të reja Bachelor, Master dhe Doktoraturës.

Fakulteti Juridik, funksion në katedra të ndara dhe ju ofron mundësi të shumta për të gjithë studentët që të përmbushin një pjesë të praktikës profesionale si pjesë e obligueshme e programit studimor në institucione shtetërore si; Ato të sistemit të drejtësisë : Gjyqësorit, Prokurorisë, Odës së Avokatëve, Ndërmjetësuesve, Përmbauesve, Noterëve, Arbitrazhit si dhe me organizatat tjera lokale dhe ato ndërkombëtare.

Ndërsa në fushën e lëndëve klinike studentët aftësohen për tregun e punës mbi bazën e ndjenjës së **vullnetarizmit**.

Të dashur student, ***Ju jeni ndryshimi për ne dhe për të gjithë rajonin.***

Pro. asoc. dr. Muharem Faiku Dekan,

Fakulteti Juridik



## **HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK**

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit Juridik me nr. të protokollit 03/417.

Ky plan strategjik është hartuar në konsultim me stafin e FJP, me aktorët relevant ne kuadër te BKI dhe institucional relevante te poshtë shënuara.

### **Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik**

Prof. asoc. dr. Armend Podvorica, kryetar

Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari, anëtar

Prof. asoc. dr. Arif Riza, anëtar

Prof. asoc. dr. Safet Krasniqi, anëtar,

Ass. Milot Krasniqi Phd.cand, anëtar,

Valeri Qatani, përfaqësuese e studentëve.

### ***Konsulent të jashtëm***

(Përfaqësues të Gjykatës Themelore)

(Përfaqësues të Prokurorisë Themelore)

(Përfaqësues të Odës Regjionale të Avokatëve, Regjioni i Prizrenit)

(Përfaqësues i KK Prizren)

(Përfaqësues i komunitetit të biznesit Regjioni i Prizrenit)

(Përfaqësues i OJQ)

(Përfaqësues të Shërbimit Sprovues)

(Përfaqësues të Shërbimit Korrektues)

(Përfaqësues i institucionit të Ndërmjetësimit)

(Përfaqësues të Odës së Noterisë, Regjioni i Prizrenit)

(Përfaqësues nga Oda e Përmbaruesve)

(Përfaqësues nga Zyra për ndihmë juridike falas)



## HISTORIKU I FAKULTETIT JURIDIK I PEGJITHSHEM

Fakultetit Juridik u themelua në vitin 2010 në kuadër të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Aktualisht, në Fakultetit Juridik studiojnë 680 studentë.

Fakultetit Juridik organizon programet e studimeve në nivel bachelor (Sistem 4 katër vjeçar).

Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme planifikon të hap programin e studimeve në nivel Master dhe të Doktoratës.

Programet aktuale te studimit në nivelin Bachelor:

- Juridik i Përgjithshëm.

### **Kërkimet shkencore të stafit akademik**

Puna e Stafit Akademik te FJP dhe aktivitetet kërkimore-shkencore e tyre janë ne kuadër të të drejtave dhe detyrimeve te përcaktuara me aktet normative ne fuqi , ne kuadër te organeve kompetente të Universitetit. Stafit Akademik te FJP merr pjesëmarrës në aktivitete kërkimore-shkencore, veprimtari botuese, pjesëmarrje në kongrese e konferenca shkencore, seminare dhe simpoziume, si pjesë e veprimtarisë kërkimore-shkencore e FJP dhe UPZ. Stafi akademik i FJP bënë kërkime shkencore dhe punë hulumtuese në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga Plani Strategjik i FJP dhe për te cilat edhe mund te financohen. Çdo anëtar i stafit akademik, do të vlerësohet një herë në vit për kontributin e tij në veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Bordit Këshillëdhënës (BKI) i shërben Fakultetit Juridik për komunikim dhe ndërveprimin me institucionet relevante te drejtësisë në komunitetin vendor dhe rajonal për kërkime shkencore dhe plotësim dhe ndryshime te planë programeve mësimore.

Infrastruktura teknike e objektit te Fakultetit Juridik aktual i plotëson kushtet e punës për staf dhe studentë. Jemi në proces të ndërtimit të godinës së re....



# 1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

## Misioni

Misioni i Fakultetit Juridik i Përgjithshëm është njësi akademike e pavarur në kuadër të UPZ-se, si njëri nga Institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Kosovës ofron programe mësimi me kualitet dhe cilësi të lartë në mësimdhënie dhe mësim nxënie të kërkimeve shkencore që të shërbejnë komunitetit dhe shoqërisë në tërësi.

## Vizioni

Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, si institucion i Arsimit të lartë ka për qëllim ofrimin e dijes në fushën e drejtësisë për studentët e komunitetit ku graviton Universiteti si tërësi.

Thellimin e bashkëpunimit me komunitetin qendror, lokal, organet Gjyqësore, Prokurori, Avokati, ekzekutive dhe shoqërinë civile.

Ky vizion synon ta shndërroj Fakultetin Juridik në vatër të aftësisë, dijes dhe vlerave të mira në formim të gjeneratave të reja profesionale.

## Vlerat

- Avancimin e dijes, mendimit kritik dhe veprimeve kreative;
- T'i promovojë dhe ruaj lidhjet afatgjate ndërmjet, studentëve, stafit universitar dhe miqve të Universitetit;
- Kultivimin e një shoqërie demokratike, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe promovimin e diversitetit kulturorë duke pasur parasysh bashkëjetesën e kulturave të ndryshme në Prizren me rrethinë;
- Sigurimin e një mjedisi miqësor dhe bashkëpunues brenda dhe jashtë institucionit.

## Palët e interesit





Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
Fakulteti Juridik

**Të brendshme:** stafi akademik; stafi administrativ dhe teknik; menaxhmenti i njësisë akademike.

**Të jashtme:** studentët; Alumni – Qendra e Karrierës (studentët e diplomuar); Institucionet e nivelit Qendror dhe atij Lokal, Institucionet Gjyqësore, Prokuroria, Zyra e Avokatit të Popullit, Oda e Avokatëve dhe Zyra për ndihmë juridike falas, Shërbimi sprovues, Shërbimi Korrektues, Akademia e drejtësisë e Kosovës, Oda e noterëve, Zyra e ndërmjetësimit dhe shoqëria civile (OJQ); komuniteti i industrisë/biznesit; komuniteti shkencor; institucionet qeveritare lokale, nacionale dhe ndërkombëtare; agjencitë e ndryshme etj.



## Qëllimet e përgjithshme

- Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësim nxënie
- Mbështetjes në fushën juridike
- Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm në plan programeve - syllabuset të lëndëve
- Nxitja dhe motivimi i nxënësve / studentëve më të mirë
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare
- Hapja e programeve të reja
- Puna vullnetare në komunitet

## Statistika të përmbledhura (Fakte të shpejta)

Studentë aktiv nga viti 2010 deri në vitin akademik 2022/23

Aktiv Meshkuj **448** 49.9%


Aktiv Femra **1097** 50.1%

Total : **1545** 100%



Nr	Fakulteti Juridik																																						
	Viti Akademik																																						
	2010/2011			2011/2012			2012/2013			2013/2014			2014/2015			2015/2016			2016/2017			2017/2018			2018/2019			2019/2020			2020/2021			2021/2022			2022/2023		
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ						
			538			204			263	102	93	195	225	207	432	344	350	694	378	448	826	346	503	849	325	567	892	128	326	451	179	411	590	140	352	492	102	324	426

Diagram: Nr. i studentëve sipas viteve



Për vitin vITI akademik 2010/11, viti akademik 2011/12 dhe viti akademik 2012/13, nuk paraqitet numri i studentëve sipas gjinisë por vetëmnumri i përgjithshëm sepse kanë qenë me student me index.



<b>Numri i Studentëve të regjistruar</b>	<b>Student</b>
<b>2010/11 – 2022/23</b>	<b>6,709</b>
<b>Numri i studentëve të diplomuar në total</b>	<b>960</b>


<b>Stafi Administrativ -</b>	<b>Numri</b>
<b>Sekretari</b>	1
<b>Stafi teknik</b>	1
<b>Staf It-isë</b>	1

<b>Lloji i Programeve</b>	<b>Emri i Programit</b>	<b>Numri</b>
<b>Bachelor</b>	Juridik i Përgjithshëm	1

<b>Numri i stafit akademik të rregulltë</b>	<b>Thirrja Akademike</b>	<b>Grada shkencore</b>
<b>8</b>	Prof. asoc. dr	Dr.
<b>2</b>	Prof.ass dr	Dr.

<b>Numri i stafit akademik të rregullt/ Punimet në nr të përgjithshëm</b>	<b>Thirrja Akademike</b>	<b>Numri i punimeve shkencore</b>
<b>16</b>	Prof.asoc. dr	<b>88</b>

<b>Aktivitetet për Staf dhe student në baza vjetore</b>				
<b>Aktivitetet Shkencore</b>	<b>Pjesëmarrje në Work Shop</b>	<b>Pjesëmarrja në Gara/Organizimii ceremonisë së diplomimit</b>	<b>Vizitat Hulumtuse/ Studimore</b>	<b>Veprimet rekreative</b>
<b>50</b>	<b>40</b>	<b>2</b>	<b>50</b>	<b>70</b>





## 2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi strategjik

Plani Strategjik 2023 – 2026, është një plan trevjeçar që paraqet të ardhmen e Fakulteti Juridik te Përgjithshëm me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara me këtë strategji. Kjostrategji do të implementohet përmes personelit akademik dhe administrative të punësuar në Universitet, komunitetit të drejtësisë përmes partneritetit publiko privat dhe të studentëve.

Ky plan fokusohet në disa objektiva të poshtëshënuara;

### *1. Studentët, Mësimi teorik dhe praktik*

Studentët në Fakultetin Juridik janë në qendër të vëmendjes dhe përmes ofrimit të dijes në aspektin teorik dhe praktik të tyre, Fakulteti arrin objektivat si njësi akademike e Universitetit.

#### *Plani mbështet në këto pika:*

- Forcimi i subjektivitetit të studentëve në vendimmarrje,
- Lehtësimi i procedurave administrative duke eliminuar pengesat burokratike përmes ofrimit të qasjes elektronike,
- Komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet profesorëve dhe studentëve përmes komunikimit fizik dhe atë elektronik,
- Platformat SMU, classroom, google meet etj, për menaxhim te procesit me përmbajtjet mësimore.
- Përshtatjen e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësim nxënies.
- Krijimi i një zyre të karrierës për ofrimin e udhëzimeve dhe mbështetjes profesionale për stafin akademik dhe administrativ.
- **Instituti për Studime Juridike dhe Politike,**
- Bashkëpunimin dhe lidhjen e marrëveshjeve dhe memorandumeve me institucione dhe institute kërkimore shkencore në Kosovë dhe më gjerë (Ndërkombëtarizimi).
- Themelimin klinikave Juridike,
- Krijimi i një biblioteke digjitale, me mundësi qasje përmes id-kartelave të studentëve dhe stafit akademik.



## Analiza e pozicionimit

### SWOT analiza e Fakultetit Juridik


Misioni i programit të Bachelor është të përgatisë studentët me aftësi teorike dhe praktike menaxhuese në kontekstin e legjislacionit modern evropian duke arrit shkathësi dhe kapacitete intelektuale të mjaftueshme për avancim në karrierë të lidhshme produktiv në sistemin e drejtësisë në institucione shtetërore administrative dhe të jurisprudencës në frymën e legjislacionit ndërkombëtare . Fakulteti Juridik në kuadër të Universiteti i Prizrenit i shërben jo vetëm rajonit të Prizrenit për regjistrimin, zhvillimin dhe edukimin e studentëve për të qenë joshës dhe të suksesshëm në tregun e punës në Kosovë dhe më gjerë. Fakulteti Juridik synon që nëpërmjet programeve që posedon dhe që aspiron në të ardhmen do të zhvillojë shkathësitë aplikative të studentëve me kompetencë, me qëllim që të jenë konkurrues në tregun e punës, të barabartë profesionalisht dhe të përgatitur me njohuri të mjaftueshme për zbatimin praktik të tyre.

Qëllimi i kësaj fushe studimi është që t'i ofroj studentëve mundësinë e fitimit të njohurive të përgjithshme juridike e cila do t'ju shërbejë atyre si bazë për specializim të mëtutjeshëm në fusha të ndryshme në lëminë juridike dhe të tjera. Në vazhdimësi është e rëndësishme të sigurohet një kuptueshmëri e interpretimit të ligjit i cili do t'i lidh aspektet e ndryshme në fushën e drejtësisë në kontekstin juridik , ekonomik dhe social. Aspirim tjetër është që studentët të familjarizohen/harmonizohen me ligjet vendore dhe ndërkombëtare dhe duke përfshirë aspektin krahasimit. Në këtë aspekt Gjuhët e huaja (angleze, gjermane, franceze, etj) , do të jetë lëndë studimore në dy semestra. Njëri nga qëllimet kryesore është sensibilizimi i studentëve me norma etike dhe profesionale në drejtësi, aplikimi i ligjit dhe vetëdijesimi i kontekstit të drejtës ligjore në shoqërinë demokratike.

Qëllim tjetër është që studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kreativë, interpretues, risive dhe komunikues në zgjidhjen e problemeve të drejtësisë në vendimmarrje duke u bazuar në përdorimin e një literature të gjerë analitike, hulumtuese dhe praktike.

- Menaxhimi i cilësisë është i rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore.
- Staf te mjaftueshëm akademik
- Procesi mësimor monitorohet nga zyra për zhvillim akademik dhe përsosmëri në kuadër të UPZ- së.
- Respektimi i standardeve ndërkombëtare në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.
- Numri konkurrues i studenteve.

- Rritja e stafit akademik, administrative dhe zgjerimi infrastrukturës.
- Angazhimi dhe bashkëpunimi i stafit akademik nga vendet e rajonit dhe te BE-se.
- Organizimi i tryezave, konferencave në përputhje me grup lëndët e lëmive përkatëse.
- Shkëmbimi i studentëve me Universitet e vendeve të BE-së
- Krijimi i mundësive, përmjet zyrës së karrierës në punësim të studentëve pas përfundimit të studimeve



- Mungesa e mjeteve financiare për realizimin e plan programit në pikat e praktikës së vizitave nëpër institucionet relevante gjatë procesit të ligjërimit.
- Mungesa e Literaturës dhe bibliotekës digjitale
- Mungesa e laboratorëve te forenzikes etj.
- Mungesa e ofrimit te studimeve ne programe te nivelit te dyte dhe te trete


- Përshtatshmëria e programit me risit e përgjithshme shoqërore.
- Krijimi i sallave të reja dhe hapësirës së praktikës brenda U niversitetit.
- Aplikimi i mësimit klinik në gjykatoren e fakultetit juridik.
- Komunikimi online mes Profesorëve dhe studentëve.
- Braktisja e studimeve – migrimi i studenteve
- Implementimi i metodave dhe eksperiencia e institucioneve ndërkombëtare në realizimin e planë programeve





## PRIORITETET STRATEGJIKE

Plani Strategjik 2023-2026 i  
Fakultetit Juridik ka identifikuar  
këto fusha me prioritet strategjik:





## **PRIORITETET STRATEGJIKE**

### **1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësim nxënie duke u bazuar në trajnimin e vazhdueshëm të stafit Akademik**

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Themelimi i zyrës për cilësi, për ECTS dhe zhvillim akademik brenda Fakultetit Juridik.
- 2: Përdorimi i metodave empirike gjatë vitit akademik (Përcjellja e vazhdueshme e aktiviteteve kërkimore shkencorë).
- 3: Plotësim ndryshimi i Syllabusëve.
- 4: Hartimi i anketave me Student.
- 5: Organizimi i trajnimeve për stafin akademik në përputhje me nevojat e ngritjes së aftësive akademike.

### **2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore dhe hapja e programeve të reja**

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Krijimi institutit kërkimor-hulumtues dhe profesional
- 2. Themelimi i zyrës për projekte dhe bashkëpunim ndërkombëtar
- 3. Themelimi i zyrës së projekteve
- 4. Themelimi i zyrës për studime klinike
- 5. Hapja e programeve në tre nivelet.



### **3. Kontributi në komunitet**

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Shkencë
- 2: Institucionet relevante shtetërore dhe private
- 3: Organizata Qeveritare dhe Jo Qeveritare

### **4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit**

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Organizimi i Shkollës Verore
- 2: Shkëmbimi i Stafit dhe studentëve
- 3: Partneriteti përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare
- 4: Lidhja e Marrëveshjeve me Institucionet relevante shtetërore dhe private nga vendi dhe rajoni.



## **5. Zhvillimi i infrastrukturës përfshirë dhe Hapjen e Institutit për studime juridike dhe politike**

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Ndërtime të sallave për lëndë klinikë(Gjykatore)
- 2: Krijimi i laboratorëve të Forenzikës dhe të mjekësisë ligjore
- 3. Hapja e Institutit për Studime Juridike dhe Politike
- 4: Biblioteka Elektronike
- 5: Krijimi i Kabineteve

## **6. Qëndrueshmëria financiare**


Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti Juridik ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1: Të hyrat Vetanake
- 2: Projekte
- 3: Grande Qeveritare
- 4: Bashkëpunimit ndëruniversitar



Të vendoset ortofoto e kampusit të UUHP

Hapësira e Fakultetit Juridik Numri i hapësirës:



## FJALA PËRMBYLLËSE

Të nderuar lexues dhe student, Fakulteti Juridik si Institucion i Arsimit të lartë është vendi i mundësive për një të ardhme të ndritur. Këtu mësohen parimet e së drejtës, "Honeste Videre, Alterum non laedere, Suum Cuique Tribuere" (Të jetosh me nder, të mos i bësh dëmash dhe të marrësh atë që të takon).

Në këtë institucion, studiohet për pjesëmarrje në të ardhmen në Institucione vendimmarrëse në nivel Qendror dhe Lokal.

Të dashur lexues e ardhmja ju takon atyre që din, munden guxojnë të marrin vendime të rëndësishme për të ardhmen. Gjatë studimeve 4 vjeçare, në Fakultetin Juridik ju do të krijoni një vizion të ndritshëm për ardhmërinë e përbashkët të brezave të rinjë.



## FJALOR I PËRMBLEDHUR

**Procesi i Akreditimit** është një proces, përmes të cilës njësit akademike paraqesin vizionin dhe misionin e tyre për të ardhmen, i cili kalon në disa faza, faza këto që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë në mësim dhënie dhe mësim nxënie.

**Procesi i Bolonjës** është marrëveshjeve midis vendeve Evropiane të dizajnuara për të siguruar krahasueshmërinë e standardeve dhe cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë. Përmes **Marrëveshjeve të Bolonjës**, procesi ka krijuar Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në veçanti nën Konventën e Lisbonës. Ajo është emëruar sipas vendit ku ishte propozuar, Universiteti i Bolonjës, me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës nga ana e Ministrave të Arsimit nga 29 shtete të Evropës në vitin 1999, duke krijuar një pjesë të integritimit Evropian.

**Zona Evropiane e Arsimit të Lartë** është (European Higher Education Area - **EHEA**) është sistem i krahasimit të arsimit të lartë sipas Bolonjës.



## PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Objektivit strategjik	Aktivitetet	Masat	Bartësit	Afati kohorë	Kostoja (Euro)
<b>Prioriteti strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësim nxënie duke u bazuar ne trajnimin e vazhdueshëm te stafit Akademik</b>						
1.	Mbikëqyrja dhe vlerësimi a) Themelimi i zyrës për cilësi, për ECTS dhe zhvillim akademik brenda Fakultetit Juridik.	Përdorimin e metodave më bashkëkohore për rritjen e cilësisë dhe standardeve ndërkombëtare.	Krijimi i modelit Class Rom	Dekani dhe Prodekani	2023-2026	10,200.00
2.	Përdorimi i metodave empirike gjatë vitit akademik (Përcjellja e vazhdueshme e aktiviteteve kërkimore shkencore organizimi i trajnimeve për mësimdhënës).	Vizitat, periodike dhe monitorimi i procesit mësimor.	Krijimi i një komisioni të veçantë(Për cilësi)	Dekani dhe Prodekani	2023-2026	15,000.00
3.	Plotësim ndryshimi i Syllabusëve brenda vitit akademik	Përshtatja e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësim nxënies	Prodekani për mësim bënë raportime në bazaditore, javore dhe mujore.	Këshilli Fakulteti	2023-2026	000,000
4.	Hartimi i anketave me Student	Matja e nivelit të mësimdhënies, mësim nxënies dhe raportin ndërmjet Studentëve me Staf Akademik dhe Administratë	Prodekani, raporte periodike	Këshilli i Fakultetit	2023-2026	000,000
5	Organizimi i trajnimeve për stafin akademik ne përputhje me nevojat e ngritjes se aftësive akademike	Trajnimi i Stafit akademik	Certifikimi i mësimdhënësve	Trajnerët e Certifikuar ne kuadër te QPM-se	2023-2026	1200





**Prioriteti strategjik 2:** Zhvillimi i punës kërkimorë-shkencore dhe hapja e programeve te reja

1.	Krijimi Institutit kërkimor-hulumtues profesional	Mundësia e ngritjes të nivelit kërkimor-hulumtues profesional të stafit akademik për nevoja akademike dhe shoqërore	Komisioni përkatës për hartimin e rregulloreve	Dekanati dhe Drejtori i Institutit	2023-2026	30,000.00
2.	Themelimi i zyrës për projekte dhe bashkëpunim ndërkombëtar	Hartimi i projekteve me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies	Komision përkatës për përgatitjen e akteve relevante	Dekani dhe Prodekani/ Udhëheqësi i Zyrës	2023-2026	10,200.00
3.	Themelimi i Zyrës së Karrierës	Aftësimin praktik të studentëve dhe përgatitja e tyre për tregun e punës	Komision përkatës për përgatitjen e akteve relevante	Dekani dhe Udhëheqësi i Zyrës	2023-2026	10,200.00
4.	Themelimi i zyrës për studime klinike	Ngritja e shkathësive të studentëve gjatë kohës së studimeve në përgatitjen e tyre për tregun e punës	Komision përkatës për përgatitjen e akteve relevante	Dekani dhe Prodekani	2023-2026	10,200.00
5	Hapja e programeve ne te tre nivelet	Përmbushja e kërkesave te tregut te punës dhe kritereve për akreditim institucional	Komision përkatës për përgatitjen e akteve relevante dhe kuadrat profesionale	UPZ /FJ	2023-2026	50000-70000



### Prioriteti strategjik 3: Kontributi në komunitet

1.	Në Shkencë	Hulumtime dhe publikime shkencore në revista me faktor ndikimi	Pjesëmarrje, në konferenca shkencore	Profesorët dhe asistentet	2023-2026	<b>40,000.00</b>
2.	Institucionet relevante shtetërore dhe private	Bashkëpunim, ndër institucional vendore	Seminare, konferenca, Tryeza shkencore, punëtori trajnime etj	Fakulteti Juridik	2023-2026	5,000.00
3.	Organizata Qeveritare dhe Jo Qeveritare	Trajnime/Tryeza	Marrëveshje Bashkëpunimi	Fakulteti Juridik	2023-2026	10,000.00

### Prioriteti strategjik 4: Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

1.	Organizimi i Shkollës Verore	Kursi Veror	Ligjërata/diskutime/shkëmbim njohurish	Fakulteti Juridik	2023-2026	10,000.00
2.	Shkëmbimi i studentëve	Hapja Konkursit për studime të integruara	Marrëveshje me Universitet ndërkombëtare	Fakulteti Juridik	2023-2026	000,000
3.	Partneriteti përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare	Bashkëpunimi me Organizata vendoredhe ndërkombëtare	Pjesëmarrja në nisma rajonale në forume të ndryshme.	Fakulteti Juridik	2023-2026	3,000.00
4.	Lidhja e Marrëveshjeve me Universitete ndërkombëtare	Memorandume Bashkëpunimi	Shkëmbim studentëve	Fakulteti Juridik	2023-2026	4,000.00



**Prioriteti strategjik 5: Zhvillimi i infrastrukturës përfshirë dhe Hapjen e Institutit për studime juridike dhe politike**

1.	Ndërtime të sallave për lëndë klinikë/ Krijimi i Kabineteve	Krijimi i sallave dhe zyrave për staf akademik dhe konsultime me studentë, përfshirë edhe aktivitetet rekreative	Rritja e stafit Akademik dhe administrativ/10 për vit akademik	Komisioni në nivel Fakulteti dhe Universiteti	2023-2026	12,000.00
2	Krijimi i laboratorëve të Forenzikës dhe të mjekësisë ligjore	Realizimi i praktikës në fushën adekuate	Mësimdhënësit / ekspertët	UPZ/FJ	2023-2026	12,000.00
3.	Hapja e Institutit për Studime Juridike dhe Politike	Ofrimi i shërbimeve elektronike për studentë dhe për studiues të drejtësisë	Kërkesa	Komisioni në nivel Universiteti	2023-2026	5,000.00
4.	Biblioteka Elektronike.	Hapësira dhe infrastruktura përcjellëse, dhe literaturë të mjaftueshme për student dhe studiues të drejtësisë	Kërkesa	Biblioteka Universitare	2023-2026	5,000.00
5.	Krijimi i kabineteve	Për realizimin e pjesës praktike dhe lëndëve procedurale.	Kërkesë	Prorektori për Buxhet dhe Financa	2023-2026	12,000.00



**Prioriteti strategjik 6: Qëndrueshmëria financiare**

1.	Përmes Të hyrave vetanake	Semestra dhe dokumente relevante	Lëshimin e dokumenteve sipas nevojave të studentëve	Administrata	2023-2026	5,000.00
2.	Nga projektet	Të cilët do të realizohen nga Instituti dhe zyra e projekteve	Hartimi i Projekteve	Instituti i cili do të themelohet	2023-2026	15,000.00
3.	Nga Donacionet	Fondet të cilat ndahen nga Organizatat ndërkombëtare	Hartimi i Projekteve	Nga Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar	2023-2026	15,000.00
4.	Bashkëpunim Ndëruniversitar	Marrëveshje me Universitetet	Memorandum	Universitetit	2023-2026	10,000.00